



INSTITUCIONET E PËRKOSSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrit

Office of the Minister

Kabinet Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Themelimi i Këshillit të Ekspertëve për Arsimin Parauniversitar (KEAP)

NUMËR: MASHT [I] 44/05

DATË: 17.8.2005

Në bazë të nenit 4.3 , 42.1 të Ligjit mbi Arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë rregullon çështjen në vijim me anë të këtij Udhëzimi Administrativ (në vazhdim, Udhëzimi).

Neni 1

Qëllimi

Me anë të këtij Udhëzimi përcaktohen kushtet e themelimit të Këshillit të Ekspertëve të Arsimit Parauniversitar (më tutje KEAP), detyrat, përbërja, veprimtaria, statusi, struktura organizative, detyrat e punës, raportimi, përgjegjësitë e KEAP dhe financimi.

Neni 2

Detyrat e KEAP

KEAP është trup këshillëdhënës që themelohet me qëllim të adresimit të çështjeve që lidhen me reformimin e arsimit parauniversitar në Kosovë

Detyrat e KEAP janë:

- Koordinon punën e gjithëmbarshme në hartimin, në zbatimin dhe në monitorimin e Strategjisë për Arsimin Parauniversitar për periudhën 2007-2017.
- Analizon gjendjen e arsimit parauniversitar në Kosovë
- Formulon rekomandime për aspekte të ndryshme të reformimit të arsimit
- Diskuton dhe propozon masat për zbatimin e projekteve dhe të veprimtarive për reformimin e arsimit
- Diskuton akte nënligjore dhe projektligje që përgatiten për tu dërguar në Kuvend dhe në Qeveri, vlerëson përputhshmërinë e tyre me politikën arsimore reformuese të arsimit.

- Shqyrton dhe diskuton arritjen e treguesve arsimorë në krahasueshmëri me ato të vendeve të zhvilluara

Neni 3

Përbërja e KEAP

KEAP përbëhet prej ekspertëve vendorë, njohës të mirë të zhvillimeve arsimore, përfaqësues të grupeve të ndryshme të shoqërisë dhe të grupeve të interesuara për zhvillimin e arsimit dhe nga konsulentë ndërkombëtarë.

Numri i anëtarëve të KEAP është njëmbëdhjetë (11), prej tyre, 3 nga MASHT, 3 konsulentë ndërkombëtarë dhe 5 të pavarur.

Ekspertët vendorë dhe konsulentët ndërkombëtarë emërohen nga Ministri për një kohë fillestare tre (3) vjeçare me mundësi vazhdimi për një periudhë tjetër.

Sekretari i KEAP është punonjës i MASHT i cili do të emërohet me Vendim të posaçëm për një periudhë 2 vjeçare me mundësi vazhdimi për një periudhë tjetër.

Neni 4

Veprimtaria

KEAP zhvillon veprimtarinë e tij përmes mbledhjeve të zakonshme, seminareve dhe formave të tjera që i konsideron të përshtatshme.

Neni 5

Statusi i KEAP

Puna e KEAP është plotësisht e pavarur dhe në përputhje me mandatin që kanë anëtarët e tij dhe të përgjegjësive të përcaktuara me këtë Udhëzim.

Neni 6

Struktura organizative

- 6.1** KEAP ka kryesuesin e tij i cili emërohet nga Ministri i MASHT, udhëheq dhe koordinon punën e gjithëmbarshme të KEAP
- 6.2** KEAP ka sekretariatit e përbërë nga Sekretari dhe asistentët administrativë. Sekretari ekzekutiv udhëheq të gjitha punët administrative të KEAP.
- 6.3** Anëtarët e tjerë të KEAP janë ekspertë dhe koordinatorë profesionalë të punëve të përcaktuara me këtë Udhëzim.
- 6.4** KEAP mund të zgjerojë fushën e veprimtarisë së tij kur kjo kërkohet nga MASHT me vendim të veçantë.

6.5 Në ndihmë të KEAP janë edhe grupet e punës, përbërja dhe detyrat e të cilëve përcaktohen me dispozita të veçanta nga KEAP dhe miratohen nga Ministri.

Neni 7

Detyrat e punës

7.1 KEAP kryen disa detyra dhe punë në përputhje me qëllimin e themelimit të tij si:

- Të hartojë planin e veprimtarisë së KEAP
- Në procesin e realizimit të ligjshmërisë, KEAP ndihmon MASHT dhe institucionet e AP në hartimin dhe rishikimin e statuteve dhe të akteve të tjera nënligjore në përputhje me ligjin dhe Strategjinë e zhvillimit të AP
- Të ndihmojë MASHT në organizimin e Konferencave dhe të ngjarjeve të tjera që kanë për qëllim zhvillimin e AP
- Të informojë dhe të raportojë së paku një herë në muaj për punën e KEAP dhe të këshillojë ministrin e MASHT për zhvillimet në AP

7.2 Konsulentët ndërkombëtarë marrin pjesë në takimet e KEAP, sjellin përvojën e vendeve të ndryshme, nga rajoni dhe bota, për AP, diskutojnë, debatojnë, sugjerojnë dhe këshillojnë KEAP dhe anëtarët e tij për çështje profesionale, ligjore dhe organizative.

7.3 Konsulentët ndërkombëtarë nuk kanë të drejtë vote në procesin e marrjes së vendimeve nga KEAP

7.4 Zyrtarët e emëruar nga MASHT, do të sigurojnë hapësirën dhe infrastrukturën e nevojshme për punën e KEAP, përcjellin punën e KEAP, japin sugjerime dhe këshilla në përputhje me ligjin dhe politikën e MASHT, në raport me arsimin e lartë dhe informojnë Ministrin dhe Sekretarin e Përhershëm për punën e KEAP.

7.6 Zyrtarët e MASHT nuk kanë të drejtë vote në punën e KEAP.

Neni 8

Raportimi

KEAP përgatit raport me shkrim së paku një herë në muaj për MASHT për zhvillimet në AP.

Neni 9

Përgjegjësitë e KEAP

KEAP është përgjegjës:

- Të nxjerrë vendime për punën e KEAP
- Të informojë, të rekomandojë, të këshillojë dhe t'i propozojë Ministrin për gjendjen dhe masat që duhet të ndërmarrë MASHT dhe institucionet e AL në zhvillimin e reformave arsimore

Neni 10

Financimi

Financimi për veprimtaritë e KEAP do të përballohet nga buxheti i MASHT.
Anëtarët e KEAP kanë të drejtën e kompensimit për punën e tyre në përputhje standardin e kryerjes së detyrave të punës që përshkruhen në kontratë, e cila nënshkruhet midis tyre dhe MASHT ku përcaktohet edhe lartësia e kompensimit, për kohën e angazhimit në KEAP.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Ministri.

Agim Veliu, Ministër